



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

Numri i Çështjes	71041-01660-11-2019	Data e Regjistrimit	6/18/2019
Numri i Vendimit	11-2019-4215	Data e Vendimit	8/1/2019

**VENDIM**  
**NE EMER TE REPUBLIKËS**

**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRES E PERBERE NGA:**

**KRYESUES:** Paulin Çera

**ANËTAR**

**SEKRETARE** Entila Shkurti

**Objekti:** Heqjen e masës të vendosur me vendimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës me date kundër kërkuesit \*\*\*\*\* , i fundur më 09.01.1962 në Peshkopi, banues në Londer, shtetas britanik i identifikuar me pashaportë nr.720111800 lëshuar nga autoritetet kompetente të Britanisë së Madhe më date 27.04.2012, e vlefshme deri me 27.01.2023, beqar, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar.

**Baza \*\*\*\*\* :** Nenet 208 e vijues të K.Pr.Penale, Nenit 151/1 të Kodit të Procedurës Penale vendimit unifikues Nr.5/2011 të \*\*\*\*\* së Lartë (nenet 293/1, 295/1, 296/1 e 2, 302, 303/2 -"b" e "d" dhe 308, etj Vendimin Unifikues Nr.3 të vitit 2002 Kushtetuta e R.SH,ne nenin 11, 42, 142/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i KEDNJ nenin 1 i Protokollit shtesë të Konventës Europjane për të Drejtat e Njeriut.

**Përmbledhja e vendimit:**

Gjykata, pasi çeli seancën gjyqësore, kreu verifikimin e prezencës së palëve dhe shqyrtoi aktet e fashikullit, pretendimet dhe provat e palëve të cilët kërkuan: **Shtetasi \*\*\*\*\* dhe mbrojtësi i tij ligjor: "Heqjen e masës së sekuestros të vendosur me vendimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës më datë 26.11.2015."**, \*\*\*\*\* : **"Rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj e prova"**

Vëren:

Në datë 17.06.2019 kërkuesi, \*\*\*\*\* është drejtuar \*\*\*\*\* së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke kërkuar heqjen e masës së sekuestros të vendosur me vendimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës më datë 26.11.2015.

Gjatë shqyrtimit gjyqësor rezultojë e provuar se më datë 26.11.2015 \*\*\*\*\* \*\*\*\*\* ka urdhëruar

regjistrimin e procedimit penal Nr. 2185, për veprën penale të *"Pastrim i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale"*, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Ky procedim penal është regjistruar mbi bazën e materialeve të referuara nga DVP Durrës, sipas të cilave shtetasi \*\*\*\*\* e \*\*\*\*\* \*\*\*\*\* kanë kryer transaksione në vlera të larta, të pajustificuara. Nga



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, me urdhrin Nr. 103, datë 25.11.2015 është urdhëruar bllokimi i përkohshëm i transaksioneve. Po në datë 26.11.2015 \*\*\*\*\* ka marrë vendimin për sekuestrimin e shumave të depozituara në llogaritë bankare në të gjitha bankat e nivelit të dytë si dhe të gjitha kasetave të sigurisë për subjektet \*\*\*\*\* , i datëlindjes 9.1.1962 dhe \*\*\*\*\* Bajram \*\*\*\*\* , i datëlindjes 2.8.1938. Janë vijuar hetimet dhe në datë 29.03.2017 \*\*\*\*\* ka marrë vendimin për pezullimin e procedimit penal Nr. 2185/2015 për shkak të dërgimit dhe ridërgimit të letërporosive autoriteteve gjyqësore Britanike, me qëllim marrjen dhe administrimin e të dhënave rreth pretendimeve të ngritura nga shtetasi \*\*\*\*\* . Rezulton se shtetasi \*\*\*\*\* në datë 10.05.2017 i është drejtuar \*\*\*\*\* së Rrethit Gjyqësor Durrës me objekt heqjen e sekuestros të vendosur në datë 26.11.2015 dhe gjykata me vendimin Nr. 27, datë 19.09.2017 ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim dhe Gjykata e Apelit Durrës me vendimin Nr. 10-2017-2513/221, datë 17.10.2017 ka miratuar vendimin e shkallës së parë.

Ndërkohë, që shtetasi \*\*\*\*\* i është drejtuar gjykatës me kërkesën objekt gjykimi duke parashtruar se llogaria bankare e sekuestruar prej më shumë se tre vite ka sjellë dëme të konsiderueshme dhe nga ana e prokurorisë duhej të veprohej shpejt. Procedimi penal i regjistruar në vitin 2015 tashmë është i pezulluar dhe priten përgjigje nga autoritetet e huaja mbi bazën e letërporosisë së dërguar atyre. Shtetasi \*\*\*\*\* është njeri i rregullt në komunitet, disponon pasaportë Britanike, nuk ka asnjë procedim penal për ndonjë vepër dhe as i dënua më parë. Vazhdimi i mbajtjes sekuestruar të llogarisë bankare ka sjellë dëm të konsiderueshëm dhe të pakthyeshëm për të. Heqja e masës së sekuestrimit dhe kthimi në gjendjen e mëparshme nuk cenon veprimet procedurale të prokurorisë dhe njëkohësisht mbrohen edhe interesat private dhe pasuria e fituar. Provat janë marrë dhe nuk ka asnjë rrezik për marrjen e tyre. Në zbatim të parimit të mbrojtjes së të drejtës së pronës dhe kapitalit monetar, kërkojmë që të hiqet masa e sekuestrimit. Vazhdimi i saj cenon në thelb lirinë dhe të drejtën e disponimit e posedimit të vlerave monetare, duke sjellë pasoja ekonomike, shëndetësore për shtetasin \*\*\*\*\* .

Nga ana tjetër, prokurorja e çështjes u shpreh për rrëzimin e kërkesës duke parashtruar se procedimi penal ka nisur pasi ka dyshime të arsyeshme të bazuara në prova për veprimtari kriminale, ndaj janë sekuestruar llogaritë bankare. Në emër të shtetasit \*\*\*\*\* , në mënyrë periodike është mbyllur një shumë prej një milion euro, me përshkrimin të ardhura nga emigracioni. Shuma e ngurtësuar nuk i përgjigjet burimit të të ardhurave dhe ka dyshime se këto të ardhura janë krijuar në mënyrë të paligjshme nga ana e shtetasit \*\*\*\*\* Toçi. Është pyetur ky i fundit i cili ka deklaruar se ndodhej në Londër si qytetar i paligjshëm. Ai ka pretenduar se një pjesë të shumës e ka përfutur



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

nga martesja e vdekjes së bashkëshortes së tij e depozituar në bankë, megjithatë shuma ishte 279.000 Paund dhe shuma është një milion euro, ky shtetas dhe i ati nuk ka me dokumentacion asnjë lloj të ardhure në mënyrë të ligjshme. I pyetur rreth këtyre fakteve tha ka qenë emigrant, jo me punë të rregullt dhe ka jetuar në shtetin e Anglisë në mënyrë ilegale dhe punët e kryera ka qenë të paregjistruar. Për shkak se informacioni duhej të merrej nga Britania e Bashkuar për aktivitetin e këtij personi në Britaninë e Madhe, lidhur me faktin e të ardhurave që ka përfutur nga trashëgimia kemi përcjellë dy letër porosi, por ende nuk kemi marrë një përgjigje zyrtare dhe për sa kohë nuk është zbardhur veprimtaria e këtij shtetasi në këtë shtet për periudhën prej 13 vitesh vlerësojmë se shuma e depozituar në emër të \*\*\*\*\*  
\*\*\*\*\* ka dyshime të bazuara se është produkt i veprimtarive kriminale, ndaj kërkoj të mos pranohet si kërkesë. Prokurorja parashtrojë se i është drejtuar me shkresat Nr. 1386 Prot, datë 26.03.2019 dhe Nr. 3375 Prot, datë 26.06.2019 Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë me qëllim që kjo e fundit të ridërgoj letërporositë autoriteteve kompetente Britanike për të marrë informacionin e kërkuar. Pavarësisht kësaj në prokurori nuk ka ardhur akoma përgjigje.

Gjykata si mori në shqyrtim kërkesën e kërkuarit, si dëgjojë palët në seancë gjyqësore dhe u konsultua me të gjitha veprimet hetimore të kryera në kuadër të procedimit penal Nr. 2185/2015, vlerëson se kërkesa është e bazuar pjesërisht dhe si e tillë duhet pranuar.

Gjykata çmon se sekuestrimi pranë bankave i parashikuar në nenin 210 të Kodit të Procedurës Penale, përbën një lloj të posaçëm të sekuestrimit të provave materiale dhe të sendeve që kanë lidhën me veprën penale, kur ato janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve, dhe përbën një mjet për kërkimin e provës, sipas nenit 208 të Kodit të Procedurës Penale. Është pikërisht qëllimi për sekuestrimin e provave që dallon këtë institut, nga sekuestroja preventive dhe ajo konservative, të parashikuar nga ligji procedural si masa sigurimi pasuror. Për shkak të rëndësisë që përbën objektin e sekuestrimit pranë bankave dhe në respektim të procesit të rregullt e të drejtë ligjor është e rëndësishme, që në arsyetimin e vendimit të gjykatës ose të prokurorit që procedon me vendimin për sekuestrimin pranë bankave të evidentohet në mënyrë të qartë dhe të detajuar marrëdhënia e sendit objekt sekuestrimi dhe veprës penale për të cilën procedohet, duke përcaktuar në çdo rast nëse kemi të bëjmë me një send që përbën provë materiale për veprën për të cilën po procedohet, apo një send që ka lidhje me veprën penale për të cilën po procedohet. Rëndësi ka të theksohet se për të gjitha rastet e sekuestrimit të sendeve pranë bankave gjykata e themelit duhet të arsyetojë në mënyrë bindëse mbi nevojën e sendit ndaj të cilit kërkohet të sekuestrimi në raport me sqarimin e fakteve që kanë të bëjnë me veprën penale.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

Gjykata vlerëson se, është pikërisht parashtrimi i arsyeve në të cilat mbështetet dyshimi për cilësimin e sendeve të parashikuara në nenin 210 të KPP (dokumenteve, letrave me vlerë, shumave të depozituara në llogari rrjedhëse dhe çdo gjëje tjetër, edhe nëse gjenden në kasetat e sigurisë) nga i cili do të mund të verifikohet dhe hetohet nga gjykata e themelit nëse aftësia e këtyre sendeve për të provuar lidhjen me veprën penale dhe për rrjedhojë nevoja për bllokimin e tyre për qëllime prove legjitimon sekuestrimin. Është e vërtetë se vendimi për sekuestrimit pranë bankave mund të ketë objekt edhe bllokimin e një shumë të hollash, sepse shpreh nevojën provuese dhe bllokimin e një marrëdhënieje juridike pasurore, vazhdimi apo kryerja e së cilës, do të sillte një cenim apo vështirësi të dukshme për vërtetimin e fakteve objekt akuze. Megjithatë, në rastin konkret, Kolegji Penal i \*\*\*\*\* së Lartë vlerëson se, dyshimi i arsyeshëm nuk mund të mbështetet në mungesën e qëllimit të qartë ekonomik, pasi në fazën e hetimeve paraprake është detyra e prokurorit të hetojë, verifikojë dhe të paraqesë në kërkesën për sekuestrim arsyet e bazuara se sendet objekt kërkesë, kanë lidhje me veprën penale për të cilën po procedohet, qoftë edhe për faktin se në Republikën e Shqipërisë sistemi ekonomik bazohet në pronën private e publike, si dhe në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike.

Duke u kthyer në rastin objekt gjykimi, konstatohet se \*\*\*\*\* ka regjistruar procedimin penal Nr. 2185/2015 për veprën penale "*Pastrimi i produkteve të veprës penale e veprimtarisë kriminale*" parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal mbi bazën e materialit paraprak të përcjelle nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës sipas informacionit të përcjelle nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave Tirane, pasi shtetasi \*\*\*\*\* kishte kryer transaksione bankare dhe kishte të akumuluar shumë prej 1.359,249 euro në llogarite të tij bankare, shumë e cila ishte e pajustificuar me burimin e të ardhurave të deklaruara nga ky shtetas dhe familjaret e tij. Në kuadër të këtij hetimi është vendosur sekuestrimi në bankat e nivelit të dytë të shumave të depozituara në llogarite rrjedhëse për shtetasit \*\*\*\*\* e \*\*\*\*\* . Me shkresën nr 34894/1 date 27.11.2015 Raiffeisen Bank është kryer bllokimi i llogarisë në emër të \*\*\*\*\* në vlerat 2.61 EURO, 1,364,926.14 EURO, 12.00 GBP, 898.28 GBP, 0.01 USD, 1.77 USD, 73.83 USD, 716.89 USD si dhe në emër të \*\*\*\*\* në vlerat 13.29 leke, 71.27 leke, 0.29 GBP, 69.27 USD. Me shkresën Nr. 1106 date 26.11.2015 Procredit Bank është bllokuar llogaria në emër të shtetasit \*\*\*\*\* në vlerat 11.15 leke, 80,266.33 euro, 0.37 USD dhe 790,824.68 leke.

Nga hetimet ka rezultuar se shtetasi \*\*\*\*\* , në vitin 1996 është martuar me shtetasen angleze Yeeta da Costa (Winterman) e datëlindjes 05.10.1935. Në 30 Prill të vitit 2001, bashkëjetuesja e tij ka vdekur. Duke qenë se ajo nuk kishte fëmijë dhe të afërm të saj, trashëgimtare, e gjithë pasuria që ajo kishte, sipas legjislacionit vendas i kalon atij. Martesën e ka



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

kryer ne Londër, ne zyrën e regjistrimit te martesave dhe ka jetuar me te, ne adresën "Lincoln House, Flat 2, 89 Westboume Tarrace W2 6QS". Pas vdekjes se saj, ka shitur shtëpinë ku kane jetuar bashke, me një vlere prej 210 000 GBP por nga kjo shume ka përfitur vetëm 70 000 GBP. Gjithashtu lidhur me burimin e te ardhurave te krijuara shtetasi \*\*\*\*\* ka deklaruar se gjate gjithë kësaj kohe ka qene emigrant ekonomik ne shtetin e Anglisë dhe se ka punuar pa qene i regjistruar pa dokument, ka punuar si mjek popullor etj. \*\*\*\*\* pranë \*\*\*\*\* se Shkallës së Pare Durrës ne vazhdim te hetimeve, ka përcjelle autoriteteve britanike dy leterporosi me ane te te cilave kërkohen marrja e provave dhe verifikimi i pretendimeve te paraqitura nga shtetasi \*\*\*\*\* lidhur me benefitet e përfituara nga martesa me shtetasen britanike Yeeta Da Costa dhe mënyrën se si i ka krijuar këto te ardhura si dhe marrjen e provave te tjera ne funksion te hetimit te zhvilluar. Është vendosur pezullimi i hetimeve te procedimit penal Nr. 2185/2015 ne pritje te leterporosise se autoriteteve britanike dhe me Vendimin e datës 26.11.2015, është vendosur sekuestrimi në Bankat e Nivelit te Dyte të shumave te depozituara në llogarite rrjedhëse, nga shtetasi \*\*\*\*\* e \*\*\*\*\* . Vendimi i mësipërm është marrë në funksion të sigurimit të provave të tjera dhe te zgjerimit te hetimeve lidhur me veprën penale të pastrimi i produkteve te veprës penale ose veprimtarisë kriminal, qe parashikohet nga neni 287 te Kodit Penal dhe u është dërguar për veprim Bankave të Nivelit të Dyte. Me shkresat Nr. 1386 Prot, datë 26.03.2019 dhe Nr. 3375 Prot, datë 26.06.2019 \*\*\*\*\* ka ridërguar përsëri leterporositë në autoritetet Britanike nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë dhe deri në këto momente nuk ka marrë përgjigje.

Nga ana e kërkuesit \*\*\*\*\* , në datë 17.06.2019 u paraqit kërkesa për heqjen e masës së sekuestrimit mbi depozitat bankare të vendosur me vendimin e datës 26.11.2015 të Prokurorisë. Gjykata në analizë të provave të administruara vlerëson se kjo kërkesë është e bazuar pjesërisht dhe se sekuestrua duhet të hiqet vetëm për shumën prej 72,863.51 Paund, shumë e cila rrjedh nga trashëgimia që bashkëshortja e tij Yeeta Da Costa i ka lënë me dëshminë e datës 23.07.2001. Në lidhje me këtë shumë, Gjykata ka vlerësimin se ka burim të ligjshëm krijimi. Duke qenë se sekuestrimi është bërë në llogari euro, shuma prej 72,863.51 Paund ti kthehet në Euro kërkuesit, duke u përlllogaritur me kursin e këmbimit të datës 26.11.2015 të Bankës së Shqipërisë. Gjykata e ka këtë vlerësim pasi praktikisht kërkuesi në këtë datë është kufizuar në disponimin e kësaj shume. Përsa i përket pjesës tjetër të shumës së sekuestruar, Gjykata vlerëson se vendimi i datës 26.11.2015 është bere ne përputhje me nenin 210 te K.Pr.Penale ne te cilin citohet se: *"1. Gjykata mund të vendosë sekuestrimin pranë bankave të dokumenteve, letrave me vlerë, shumave të depozituara në llogari rrjedhëse dhe çdo gjëje tjetër, edhe nëse gjenden në kasetat e sigurisë, kur ka arsye të bazuara për të menduar se ato kanë lidhje me veprën penale, edhe kur*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR**  
**DURRES**

*nuk i përkasin të pandehurit ose kur nuk janë në emër të tij. Në raste të ngutshme ky vendim mund të merret nga prokurori".* Mbi bazën e dyshimeve të krijuara për origjinën, burimin e këtyre shumave të depozituara referuar dhe veprimeve bankare të kryera si tërheqje apo depozitime të shpeshta të kryera në llogarinë e kërkuesit \*\*\*\*\* është vënë sekuestro mbi këto depozita. Ky vendim nuk është nxjerre në bazë të ligjit Nr. 10192 dt. 03.12.2009 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" por është marrë në zbatim të nenit 210 të K.Pr.Penale në funksione të një hetimi penal dhe jo hetimi administrativ-pasuror. Gjykata vëren po ashtu se shkaqet e ngritura dhe të parashtruara në gjykim nga kërkuesi nuk çojnë në pranimin plotësisht të kërkesës së tij. Deri në këtë fazë të procesit, kërkuesi nuk justifikon ligjërisht shumën tjetër të depozituar në emër të tij në bankë.

Sakaq, kërkesa e kërkuesit \*\*\*\*\* gjendet pjesërisht e bazuar në prova e ligj dhe si e tillë duhet pranuar.

**Për keto arsye:**

Baza \*\*\*\*\* :

***Gjykata, bazuar në nenet 210 dhe 212 të K.Pr.Penale,***

Vendosi:

**VENDOSI**

1. Pranimin pjesërisht të kërkesës së kërkuesit \*\*\*\*\*
2. Heqjen e sekuestros së vendosur me vendimin e datës 26.11.2015 të Prokurorisë pranë \*\*\*\*\* së Shkallës së Parë Durrës, vetëm për pjesën prej 72,863.51 paund dhe kthimin e kësaj shume kërkuesit \*\*\*\*\*
3. Rrëzimin e kërkesës për pjesën tjetër si të pabazuar në ligj dhe në prova.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 (pesë) ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes.

**U shpall, sot në Durrës, më datë 19 Korrik 2019.**

Ky dokument është marrë nga [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al). Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.